

SHOQATA ELEKTROTEKNIKE E KOSOVËS
KOMITETI NACIONAL CIGRE KOSOVË



SHOQATA ELEKTROTEKNIKE E KOSOVËS
Komiteti Nacional CIGRE Kosovë - KN CIGRE KO
Nr. 18 Dt. 28/02/2018
PRISHTINË

STATUTI I KN CIGRE KOSOVË

Shoqata Elektroteknike e Kosovës – KN CIGRE KO ka miratuar plotësim - ndryshimet në përputhje me kërkesat e Statutit të CIGRE Internacionale dhe Rregullores së Punës

KN CIGRE KO

Rr. Isa Boletini Nr. 39, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
e-mail: info@cigre-ks.com
web: www.cigre-ks.com

Shkurt 2018



STATUTI

I

SHOQATËS ELEKTROTEKNIKE TË KOSOVËS - KOMITETI NACIONAL CIGRE KOSOVË

Ky Statut përcakton qëllimin dhe veprimtarinë e Komitetit Nacional CIGRE Kosovë i cili vepron në kuadër të Shoqatës Elektroteknike të Kosovës.

Neni 1

Emri dhe Themeluesi

- 1.1 Shoqata formalisht mban emrin "Shoqata Elektroteknike e Kosovës".
- 1.2 Komiteti Nacional CIGRE Kosovë është themeluar në kuadër të Shoqatës dhe njihet me shkurtesën "KN CIGRE KO".
- 1.3 Shoqata (duke përfshirë edhe KN CIGRE KO) drejtohet në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare të Republikës së Kosovës.

Neni 2

Kushtet e Përgjithshme

- 2.1 Komiteti Nacional CIGRE Kosovë është degë e Komitetit Internacional për Sistemet e Mëdha Elektrike - *Conseil International des Grands Réseaux Électriques - CIGRÉ - PARIS*. Është organizatë e pavarur, me bazë vullnetare dhe me të drejtë për të qenë anëtare në përputhje me Statutin e CIGRE Internacionale.
- 2.2 KN CIGRE KO gjithashtu mund të bëhet partnere bashkëpunimi me organizata tjera ndërkombëtare dhe/ose vendore.
- 2.3 Komiteti Nacional CIGRE Kosovë (në tekstin në vijim referuar si "KN CIGRE KO") merret kryesisht me çështjet profesionale dhe shkencore si nga sfera vendore ashtu dhe ajo ndërkombëtare, në lidhje me prodhimin, transmisionin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, prodhimin e pajisjeve elektrike si dhe me çështjet e sistemit të energjisë elektrike.

Neni 3

Selia

- 3.1 Selia e KN CIGRE KO ndodhet në Rr. Isa Boletini Nr. 39 (ndërtesa e KOSTT-it), 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.



Neni 4

Vula dhe Logo e Shoqatës Elektroteknike të Kosovës, Komiteti Nacional CIGRE Kosovë

- 4.1 Logo e KN CIGRE KO është identike me atë të CIGRE Internacionale, përveç që poshtë CIGRE është shtuar Kosovë/Kosovo. Vula ka formë të rrumbullakët me perimetër prej 3 cm dhe brenda saj shkruan Komiteti Nacional CIGRE Kosovë.

Neni 5

Objektivat e Komitetit Internacional për Sistemet e Mëdha Elektrike CIGRE

- 5.1 Shoqata është themeluar me qëllim kryesor zhvillimin dhe lehtësimin e shkëmbimet të njohurive inxhinierike dhe informacioneve në fushën e sistemeve të mëdha të energjisë elektrike (qëllim të edukimit dhe këshillimit nga lëmi i elektroteknikës)
- 5.2 Zhvillimi dhe lehtësimi i shkëmbimit të njohurive inxhinierike dhe informacionit mbi sistemet elektrike;
- 5.3 Shtimi i vlerës në njohuritë dhe informacionet e shkëmbyera duke sintetizuar praktikat më të avancuara botërore;
- 5.4 Vënia në dispozicion e punës së CIGRE për akterët e industrisë së energjisë elektrike: për inxhinierë, specialistë dhe menaxherë, vendimmarrës, rregullatorë dhe për komunitetin akademik. Më konkretisht, çështjet e lidhura me zhvillimin, operimin dhe menaxhimin e sistemeve elektrike si dhe projektimi, ndërtimi, mirëmbajtja e pajisjeve dhe impianteve janë thelbi i misionit të CIGRÉ.

Neni 6

Objektivat e KN CIGRE KO

- 6.1 Zbaton dhe promovon objektivat e Komitetit Internacional për Sistemet e Mëdha Elektrike CIGRE;
- 6.2 Inkurajon anëtarësimin në CIGRE dhe bërjen e CIGRE-së më të njohur në Kosovë;
- 6.3 Organizon përfaqësimin e KN CIGRE KO në konferenca dhe simpoziume;
- 6.4 Propozon dokumente për prezantim në konferenca (në pajtim me rregullat e dhëna nga 'Rregullat e Përgjithshme për Konferenca të CIGRE Internacionale');
- 6.5 Rekomandon anëtarë të KN për anëtarësim në Komitetet Studiuuese;
- 6.6 Promovon takime të Komiteteve Studiuuese dhe Grupeve Punuese në Kosovë;
- 6.7 Organizon takime teknike dhe / ose ngjarje të tjera në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me organizata që kryejnë aktivitete të ngjashme;
- 6.8 Vepron si ndërlidhës midis zyrës qendrore të CIGRÉ Internacionale dhe anëtarëve në Kosovë.

Neni 7

Synimi i KN CIGRE KO

- 7.1 Nxitja dhe dhënia e udhëzimeve për hulumtime origjinale relevante për sistemet elektrike;
- 7.2 Informimi i publikut për punën e KN CIGRE KO.
- 7.3 Funkzionet tjera të Komitetit Nacional janë përcaktuar në Rregulloren e Punës së CIGRE.

Neni 8

Anëtarësimi në KN CIGRE KO

- 8.1 Anëtarë të KN CIGRE KO mund të jenë:
 - a. Anëtarët individual I - janë individ të përfshirë në industri (inxhinierë, menaxherë, hulumtues, profesorë, etj.);
 - b. Anëtarët individual II (anëtarë të rinj), të moshës nën 35 vjeç – ata paguajnë vetëm gjysmën e tarifës për 2 vitet e para të anëtarësimit;
 - c. Anëtarët studentë - janë individ të cilët janë duke punuar në tema të diplomës së arsimit të lartë (kategori e përfshirë në vitin 2015);
 - d. Anëtarët kolektiv I - përbëhen nga kompani publike ose private me karakter industrial dhe / ose komercial, organizata shkencore dhe teknike, institute kërkimore, organe administrative etj.;
 - e. Anëtarët kolektiv II - përbëhen nga universitete dhe organe të tjera arsimore;
 - f. Anëtar nderi - anëtar individual të zgjedhur nga Bordi Teknik Nacional për kontributin e tyre të veçantë dhënë Shoqatës dhe KN CIGRE KO;
 - g. Gjithashtu, do të ketë anëtarë të Komitetit në kapacitetin ex-officio.
- 8.2 Anëtarët Ekuivalent
 - a. Anëtarët Individual përfaqësojnë një (1) anëtar ekuivalent në KN CIGRE KO;
 - b. Anëtarëve Kolektiv I u lejohe emërimi deri në gjashtë (6) përfaqësues që përfaqësojnë deri në gjashtë anëtarë ekuivalent në KN CIGRE KO;
 - c. Anëtarëve Kolektiv II u lejohe emërimi deri në tre (3) përfaqësues që përfaqësojnë deri në tre anëtarë ekuivalent në KN CIGRE KO.
- 8.3 Anëtarësimi në KN CIGRE KO fitohet përmes regjistrimit vullnetar, aplikimit individual të paraqitur pranë Sekretarit, duke paguar tarifën e anëtarësisë dhe regjistrimin në regjistrin e anëtarësisë.



Neni 9

Të Drejtat dhe Obligimet e Anëtarëve

9.1 Të Drejtat Themelore të Anëtarëve

- a. Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e KN CIGRE KO;
- b. Të jetë anëtar i Komiteteve Studiuese;
- c. Të marrë pjesë në aktivitetet e KN CIGRE KO;
- d. Të propozojë iniciativa në interes të punës së KN CIGRE KO;
- e. Të informohet për punën e KN CIGRE KO.

9.2 Përgjegjësitë e Anëtarëve

- f. Anëtarët janë të obliguar të paguajnë tarifë vjetore të anëtarësimit;
- g. Tarifa vjetore e anëtarësimit do të përcaktohet nga KN CIGRE KO;
- h. Në rast të mos pagesës për një periudhë më të gjatë se 2 vjet, anëtari i KN CIGRE KO mund të përjashtohet;
- i. Anëtarët e nderit nuk paguajnë tarifa;
- j. Anëtarët janë të detyruar të zbatojnë të gjitha dispozitat e këtij Statuti dhe aktet e tjera të KN CIGRE KO.

9.3 Anëtari individual ose kolektiv, të cilit i është vënë në pikëpyetje e drejta për anëtarësim, mund të paraqesë ankesë pranë Sekretariatit.

Neni 10

Mirënjohjet për Anëtarët

- 10.1 Për punën e tyre, anëtarët mund të marrin shpërblime, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: shpërblime për përvojën jetësore, pllakatë, mirënjohje, diploma dhe çmime;
- 10.2 Kushtet e nevojshme për të fituar mirënjohje përcaktohen në Rregulloren mbi mirënjohje të KN CIGRE KO;
- 10.3 Të gjitha mirënjohjet për anëtarë dhurohen publikisht në takimet e rregullta, në konferencat e Komitetit Nacional ose në ceremonitë e hapura;
- 10.4 Sekretari mban një regjistër të mirënjohjeve.

Neni 11

Organet e KN CIGRE KO janë:

- a. Kuvendi i Komitetit Nacional
- b. Kryesia e KN CIGRE KO
- c. Bordi Teknik Nacional (BTN)
- d. Komitetet Studiuese
- e. Një person i autorizuar për përfaqësim
- f. Sekretariati.



Neni 12

Kuvendi i Komitetit Nacional

Komiteti Nacional është krijuar për ta bërë CIGRE Internacionale më të njohur dhe për të shtyrë përpara interesat e saj në vendin në fjalë. Komiteti Nacional (KN) vepron si një fokus për anëtarët vendor për të promovuar aktivitetet e CIGRE në vendet e tyre përkatëse. KN-të fqinje mund të krijojnë një CIGRE Rajonale për të trajtuar çështjet rajonale në mënyrë më efikase.

- 12.1 Kuvendi i Komitetit Nacional është organi më i lartë udhëheqës i KN CIGRE KO dhe përbëhet prej gjithë anëtarëve ekuivalent të Komitetit Nacional;
- 12.2 Kuvendi i Komitetit Nacional është përgjegjës për politikën drejtuese dhe financiare të KN CIGRE KO;
- 12.3 Rregullat e Kuvendit të Komitetit Nacional nuk mund të jenë në asnjë rast në kundërshtim me Statutin e CIGRE Internacionale;
- 12.4 Përveç detyrave tjera të përcaktuara në statut, Kuvendi i Komitetit Nacional do të ketë edhe përgjegjësi tjera si në vijim:
 - a. Konfirmon Statutin dhe plotësim-ndryshimet;
 - b. Konfirmon planin financiar dhe raportin vjetor të punës së KN CIGRE KO;
 - c. Përditëson Rregullat dhe Procedurat e Komitetit Nacional me Rregullat e CIGRE Internacionale;
 - d. Zgjedhë dhe shkarkon kryesuesin, zëvendës kryesuesin, anëtarët e Komitetit Nacional dhe konfirmon sekretarin e përgjithshëm të KN CIGRE KO;
 - e. Ndhmon në mbledhjen e fondeve dhe përcakton tarifën e anëtarësimit për KN CIGRE KO;

Neni 13

Mbledhjet e Kuvendit të Komitetit Nacional

- 13.1 Kuvendi i Komitetit Nacional mbledhet së paku një (1) herë në vit;
- 13.2 Kryetari i Kuvendit të Komitetit Nacional duhet të thërret mbledhjet e Kuvendit kurdo që kërkohet nga anëtarësia mbi 50%+1 anëtarë;
- 13.3 Kryesia e KN CIGRE KO mund të thërrasë mbledhje të veçantë të Kuvendit të Komitetit Nacional, me kërkesë të kryesuesit ose cilitdo prej anëtarëve kolektiv të KN CIGRE KO, me kusht që:
 - a. Njoftimi të bëhet jo më pak se 7 ditë përpara;
 - b. Agjenda me pikat e diskutimit për takim, duke i bashkangjitur dëshminë e kërkesës nga njëri prej anëtarëve kolektiv.
- 13.3 Pjesëmarrja minimale e anëtarëve për fillimin e mbledhjes të Kuvendit të Komitetit Nacional do të jetë 50% + 1 anëtar. Nëse ky kuorum nuk plotësohet, takimi shtyhet për një ditë tjetër;
- 13.4 Raporti mbi pasuritë, detyrimet, të hyrat, shpenzimet dhe programin e punës së KN CIGRE KO për vitin e mëparshëm dhe atë të radhës do të analizohet dhe pranohet gjatë takimit vjetor të Kuvendit të Komitetit Nacional;
- 13.5 Secili anëtar i Kuvendit të Komitetit Nacional ka të drejtën e një (1) vote;
- 13.6 Vendimet e Kuvendit të Komitetit Nacional merren nga shumica e anëtarëve të pranishëm gjatë mbajtjes së Kuvendit të Komitetit Nacional.



Neni 14

Kryesia e KN CIGRE KO

14.1 Kryesia e KN CIGRE KO përbëhet nga:

- Kryesuesi
- Zv. kryesuesi
- Sekretari.

Neni 15

Bordi Teknik Nacional (BTN)

- 15.1 Bordi Teknik Nacional konsiderohet si organi Ekzekutiv i Komitetit Nacional CIGRE Kosovë;
- 15.2 Kryetar i Bordit Teknik Nacional mund të jetë njëkohësisht edhe kryesuesi i KN CIGRE KO;
- 15.3 Në mungesë të tij/saj, kryetari do të zëvendësohet nga zëvendëskryetari;
- 15.4 Anëtarët e Bordit Teknik Nacional përfshijnë: kryesuesin dhe zv. kryesuesin e KN, kryetarët e Anëtarëve Kolektiv (ose zëvendësit) dhe një anëtar ex-officio që përfaqëson institucionet dhe/ose rregullatorin e energjisë;
- 15.5 Mandati i anëtarëve të BTN-së është katër (4) vjeçar me mundësi të ri-zgjedhjes;
- 15.6 Sekretari i KN CIGRE KO konsiderohet anëtar i BTN-së pa të drejtë vote.

Neni 16

Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Bordit Teknik Nacional (BTN)

- 16.1 Kryetari thërret mbledhjet e BTN-së, kryeson mbledhjet, përfaqëson BTN-në, propozon rendin e ditës dhe udhëheqë takimet;
- 16.2 Kryetari zbaton aktivitete të tjera të caktuara nga BTN-ja në bazë të konkluzioneve paraprake të propozuara nga shumica e thjeshtë e anëtarëve të KN-së;
- 16.3 Kryetari dhe zv. kryetari i BTN-së raportojnë në KN për punën e tyre;
- 16.4 Mandati i kryetarit dhe zv. kryetarit të BTN-së është katër (4) vjet me mundësi rizgjedhjeje.

Neni 17

Mbledhjet e Bordit Teknik Nacional (BTN)

- 17.1 BTN do të takohet sipas nevojës, por së paku një herë (1) në çdo gjashtë (6) muaj;
- 17.2 Puna e BTN-së rregullohet me Rregullat dhe Procedurat e miratuara nga KN;
- 17.3 Vendimet e BTN-së do të jenë të vlefshme vetëm nëse kanë votuar shumica e anëtarëve të pranishëm.



Neni 18

Kompetencat e Bordit Teknik Nacional (BTN)

- 18.1 Bordi Teknik Nacional është kompetent që të:
- a. Përgatitë dhe zbaton vendimet e KN CIGRE KO;
 - b. Zbaton programin e punës të KN-së;
 - c. Përgatitë propozimet për plotësim - ndryshimet e Statutit të KN-së;
 - d. Përgatitë dokumente të shkruara për mbledhjet e KN-së;
 - e. Përgatitë propozime për formimin e Komiteteve Studiuese;
 - f. Përgatitë agjendën dhe raportin për takimin e radhës;
 - g. Kryetari i BTN-së është i obliguar të raportojë në mbledhjen vjetore të KN CIGRE KO dhe të përgatitë deklaratën për përfshirje në procesverbalin e mbledhjes vjetore.

Neni 19

Komitetet Studiuese (KS)

- 19.1 Komitetet Studiuese janë forma themelore organizative e Komitetit Nacional CIGRE Kosovë;
- 19.2 Çdo Komitet Studiues përfshinë një fushë të veçantë teknike që ka të bëjë me sistemet elektrike;
- 19.3 KN CIGRE KO do të konfirmon përzgjedhjen e anëtarëve për emërim në Komitetet Studiuese(KS) të CIGRE, sipas propozimeve të Bordit Teknik Nacional, duke pasur parasysh profilin e kërkuar nga Komiteti Studiues përkatës. Mandati i anëtarëve në KS është i kufizuar sipas procedurave të CIGRE Internacionale deri në gjashtë (6) vite, me mundësi për rizgjedhje edhe për dy(2) vite nëse anëtarët janë jashtëzakonisht aktiv;
- 19.4 KN CIGRE KO me propozimin e Bordit Teknik Nacional dhe të kryetarëve të Komiteteve Studiuese konfirmon kandidimin e anëtarëve në Komitetet Studiuese të CIGRE Internacionale;
- 19.5 Sekretari do t'i procedojë vendimet ne Zyrën Qendrore të CIGRE Internacionale në Paris;
- 19.6 Puna e Komiteteve Studiuese është e organizuar në përputhje me Rregullat dhe Procedurat e CIGRE Internacionale të cilat rregullojnë aktivitetet teknike të Komiteteve Studiuese.



Neni 20

Sekretariati

- 20.1 Sekretariati përbëhet nga Sekretari, Administratori dhe Kontabilisti.
- 20.2 Sekretari i KN CIGRE KO gjithashtu është edhe Sekretar i Shoqatës (SHETK).
- 20.3 Sekretari është gjithashtu arkëtar dhe emërohet për një mandat katër (4) vjeçar me mundësi ri-zgjedhjeje.
- 20.4 Sekretari është përgjegjës për:
- Organizimin e përgatitjes së materialeve për takimet e KN CIGRE KO;
 - Ndihmon kryesuesin në hartimin e vendimeve të Komitetit Nacional;
 - Asiston në marrëdhëniet midis Komiteteve Studiuuese dhe grupeve të punës;
 - Është person kontaktues nga KN CIGRE KO për CIGRE Internacionale;
 - Organizimin e punimeve përgatitore për konferenca, këshillime, simpoziume, vizita studimore etj.;
 - Vepron si përfaqësues i KN CIGRE KO në takimet bienale të Sekretarëve Nacional në Paris;
 - Mbanë procesverbalin e të gjitha mbledhjeve të KN duke e shpërndarë atë tek anëtarët e KN, sipas nevojës;
 - Menaxhon dhe mirëmban të gjithë dokumentacionin që lidhet me udhëheqjen e KN CIGRE KO.
- 20.5 Detyrat e Arkëtarit janë si në vijim:
- Mbledhja e anëtarësisë vjetore nga anëtarët e KN CIGRE KO
 - Realizimi i pagesës vjetore i anëtarësisë për CIGRE Internacionale
 - Menaxhimi i bazës së të dhënave të anëtarësisë, duke siguruar të dhënat sipas nevojës për zyrën qendrore të CIGRE;
 - Menaxhimi i llogarisë bankare të CIGRE Kosovë;
 - Ofrimi i pasqyrave financiare dyvjeçare (bienale) që janë rishikuar në mënyrë të pavarur.
- 20.6 Administratori ndihmon në kryerjen e detyrave të Sekretariatit

Neni 21

Shpërbërja e Shoqatës

- 21.1 Shoqata mund të shpërblehet me vendimin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit.
- 21.2 Kur të vendoset për shpërbërjen e shoqatës, Kuvendi do të tregojë emrin e shoqatës ose fondacionit që do të marrë pasurinë e mbetur, pasi shoqata të jetë liruar nga detyrimet. Shoqata ose fondacioni i zgjedhur duhet të ketë qëllime të njëjta ose të ngjashme sikurse shoqata elektroteknike.

Neni 22

Bashkëpunimi me Organizata Tjera

KN CIGRE KO mund të realizojë anëtarësime në organizata tjera profesionale ose forma tjera të bashkëpunimit.



Neni 23

Ndryshimet e Statutit

Komiteti Nacional ka mundësi për plotësim – ndryshim të Statutit dhe Rregullores së Punës, duke përjashtuar mundësinë që çfarëdo modifikimi të bie në kundërshtim me Statutin e CIGRE Internacionale. Statuti dhe Rregullorja e Punës do të mbahen nën shqyrtim nga Komiteti Nacional dhe duhet të rishikohen sipas nevojës, duke iu nënshtruar aprovimit në mbledhje të radhës të anëtarëve të KN CIGRE KO.

23.1 Statuti mund të ndryshohet me vendimin e 50% +1 vota të shumicës së anëtarëve të Kuvendit të Komitetit Nacional

Neni 24

Financimi i Komitetit Nacional

Në pajtim me nenin 18 të Statutit të CIGRE Internacionale, KN CIGRE KO vepron si agjent për mbledhjen e anëtarësisë vjetore dhe rezervon të drejtën për të shtuar një taksë për këto anëtarësime për të ndihmuar në përmbushjen e shpenzimeve të saj vetanake. Të ardhurat e kërkuara nga KN CIGRE KO për të financuar aktivitetet e veta mund të plotësohen nga donacione dhe / ose kontribute të tjera.

- 24.1 Për të arritur synimet e saja, KN CIGRE KO do të marrë fonde nga:
- Tarifat e anëtarësimi të anëtarëve kolektiv dhe individual;
 - Tarifat për pjesëmarrje për konferenca, simpoziume dhe seminare;
 - Sponsorizimi i aktiviteteve të KN CIGRE KO sipas Udhëzimeve të CIGRE Internacionale;
 - Të ardhura tjera në pajtim me ligjin dhe me këtë Statut.

Neni 25

Periudha e Raportimit Financiar

25.1 Komiteti Nacional CIGRE Kosovë i themeluar në kuadër të Shoqatës është i obliguar me ligj të caktojë një kontabilist të pavarur për të vërtetuar llogaritë dhe për të ofruar raport financiar vjetor.

25.2 Viti financiar është i njëjtë me vitin kalendarik.

Prishtinë
28 Shkurt 2018



Kryetari
Prof. Dr. Mehmed BULA

Mehmed Bula